Prezanton Vilson Sula. Veap Halili pyet pse lindi nevoja për krijimin e OJF dhe ku u pa nevoja që Bashkia jone ka nevojë për trajnimet. Vilson Sula thotë që gjithmonë lind nevoja për trajnime pasi ndryshojnë VKM, Ligjet etj. Bashkitë do të japin Kontributin me të vogël, thotë Vilson Sula. Hidhet në votim dhe miratohet me 11 vota pro, 2 kundër, 1 abstenim.

Projekt vendim për miratimin e fondit për ndihmë shtetërore financiare për znj. Mimoza Kona. Prezanton Selim Alliu. Hidhet në votim dhe miratohet me 13 vota pro dhe për Leke Kika 12 vota pro.

Projekt vendim “Për përdorimin të fondit të emergjences për ndërhyrje emergjente”. ndërtim muri, mbajtes etj. Nuk hidhet në votim pasi nuk ka kaluar në komision.

Firmosur nga:

Valbona Jani Edmond Durruci Silva Duka Mariglen Dani Ravjola
Kaja Greta Tançi Behar Çani Shkëlqim Begu Arben
Çupi Endrit Meta

Mbajtës i procesverbalit:

Klodian Recu

Procesverbal

Procesverbal i mbajtur sot me datë 30.09.2025 në sallën e Këshillit Bashkiak Bulqizë.

Marrin pjesë këshilltarët:

Arben Çupi Valbona Jani Endrit Meta Arjan Hoxha Shkëlqim Begu Veap Halili Ylli Xhafa Elkier
Duriçi Edmond Duriçi Mariglen Dani Ravjola Kaja Visjana Limani Brulind Sinani Gëzim Xhafa.

Arben Çupi hap mbledhjen. Lexon rendin e ditës.

Veap Halili kërkon përgjigje për shkresën që kanë bërë nga disa këshilltarë dhe përgjigja të jetë me shkresë zyrtare. Hidhet në votim rendi i ditës. Shkëlqim Begu kërkon që të hiqet pika 8 e rendit të ditës. Miratohet me 11 vota pro, 3 kundër dhe asnjë abstenim.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së muajit gusht 2025, datë 04.09.2025. Arjan Hoxha kërkon që

në procesverbal të shkruhen dhe shqetësimet që ngremë në mbledhje.

Veap Halili propozon që në mbledhjet e Këshillit, në procesverbal të shkruhen emrat e këshilltarëve që votojnë pro, kundër apo abstenim.

Hidhet në votim miratimi i procesverbalit me 11 vota pro, 1 abstenim, 2 kundër.

Pika të ndryshme: Endrit Meta pyet për kërkesën që ka bërë në lidhje me ujësjellsin e Peladhisë dhe Liqenit të Thatë.

Veap Halili nëse është diskutuar për rrugën e Zonës D. Dhe meqe jemi në prag të konsultimeve publike, të futet në buxhetin e vitit të ardhshëm.

Z. Albion thotë që do të bëjmë kërkesë bizneseve si dhe që të gjejmë një zgjidhje.

Edmond Duriçi pyet për rrugën Duriçe.

Z. Albion thotë që është në fazë vlerësimi.

Z. Mariglen Dani pyet për pedonalen në qytet të ri. Z. Albion përgjigjet se do të marrin dhe mendimet e qytetarëve.

Nuk është bërë konsultim më parë pasi është projekt rikonstruksioni. Z. Mariglen Dani thotë që nuk duhet bllokuar rruga. Z. Albion thotë që nuk është vendosur nëse do të mbyllet përfundimisht, por do të diskutohet.

Z. Haxhi Pulja thotë që përderisa nuk ka përfunduar plotësisht, nuk mund të hapet.

Endrit Meta dhe Veap Halili thonë që duhet bërë studim nga urbanistika. Z. Vilson Sula thotë që është marrë Drejtoria e Shërbimeve dhe është mirëmbajtje dhe jo investim. Nëse doni informacion më shumë, të bëhet një kërkesë dhe një person përgjegjës të sjelle dokumentacionin e nevojshëm për pedonalen e qytetit të ri.

Shëlqim Begu thotë që kanë ardhur materiale për ndriçim dhe pyet se cilat fshatra do të përfshije. Z. Haxhi Pulja thotë që do të jenë në të gjitha njësitë. Z. Arjan Hoxha thotë që mbledhjen e kaluar ka kërkuar që punëtorët e mirëmbajtjes të jenë në punë dhe të mirëmbajnë rrugët. Z. Haxhi Pulja thotë që punëtorët janë në gatishmëri në Gjoricë, ndërsa 2 punëtorë janë lënë në Zerqan dhe normalisht duhet të kishin ndërhyrë në mirëmbajtje.

Z. Arjan Hoxha pyet për kondicionerët dhe printërat. Janë në procedurë të prokurimit. Diskutohet për buxhetin e Këshillit. Këshilli Bashkiak ka miratuar vlerën rreth 1.7 mil lek. Ndërsa në zyrat e financës është 1.3 milion të reja.

Veap Halili propozon:

- 1- Krijimin e një komisioni për ndjekjen dhe hetimin e procedurave të investimeve, pedonale, Vajkal, dhe ujësjellësi Peladhi.
- 2- Mbledhjen e ardhshme auditit i brendshëm të raportojë mbi mbarëvajtjen e punëve të Bashkisë.

Projekt vendim për përdorim 6% të fondeve për muajin gusht 2025. Prezanton Korab Kika. Shpjegon hyrje daljet nga sistemi dhe arsyet e tyre.

Hidhet në votim dhe miratohet me 14 vota pro.

Projekt vendim për ndihmë financiare për zonjë Erlina Kamberi. Elkier Duriçi propozon që shuma për Erlinën të jetë më e madhe. Diskutohet për Erisild Beta dhe Majlinda Hoxha.

Për Erlina Kamberi shuma 70000 lek

Për Erisild Beta shuma 70000 lek

Për Majlinda Hoxha shuma 50000 lek

Të tre projektet miratohen me 15 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Projekt vendimi për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028.

Prezanton Matilda Isaku. Hidhet në votim me 10 pro, 3 kundër dhe 1 abstenim.

Endrit Meta pyet Matildën për kërkesën e ujësjellsit dhe kanalit e Liqenit të Thatë.

Matilda thotë që informacionin e zyrës së urbanistikës e ka dërguar dhe duhet të prisni përgjigje nga ata.

Projekt vendim për disa të ndryshme në VKB Nr 89 datë 26.12.2024. Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë për vitin 2025. Prezanton Haxhi Pulja. Hidhet në votim me 8 vota pro, 2 kundër, 1 abstenim.

Veap Halili kërkon që informacioni i kërkuar në mbledhjen e Komisionit për zyrën e pyjeve në lidhje me dëgjuesën publike, të prezantohet nga drejtori përkatës.

Veap Halili kërkon që dëgjesa të bëhet për çdo njësi të qeverisjes vendore për të cilat preken prona që parashikohen të jepen me ankand, qira.

Të njoftohen banorët që preken nga dhënia e këtyre pronave me qira për çdo parcelë ose pronë që parashikohet të jepet. Kjo dëgjese pa praninë e banorëve nuk i plotëson kriteret ligjore.

Ravjola Kaja

Valbona Jani

Visjana Limani

Maringlen Dani

Arben Çupi

Endrit Meta

Shaqir Manjani

Mbajtës i procesverbalit

Sekretari: Klodian Reçi

Procesverbal

Procesverbal i mbajtur sot me datë 06.11.2025 në sallën e Këshillit Bashkiak Bulqizë për mbledhjen e muajit tetor 2025.

Marrin pjesë këshilltarët:

Arben Çupi Valbona Jani Endrit Meta Arjan Hoxha Shkëlqim Begu Veap Halili Elkier Duriçi Edmond Duriçi Maringlen Dani Ravjola Kaja Brulind Sinani Ernold Çupi Munir Sinani Arjan pasha Behar Cani Arjan Hoxha.

Hidhet ne votim rendi I dites dhe miratohet me 11 vota pro dhe 1 kunder.

Miratimi I procesverbalit te mbledhjes . Hidhet ne votim me 11 vota pro dhe 1 kunder dhe 3 abstenim.

Tek te ndryshmet : Shkelqim Begu kerkon qe te merren masa per Lagjen Vajkal. Elkier Duriçi per kryeplakun e fshatit Vajkal duke gene se ka dhene doreheqjen. Endrit Meta kerkon pergjigje me shkrese per informacionin e kerkuar ne lidhje me ujesjellesin e Peladhise dhe Liqenin e Thate. Z.Albin thote se nesoer do te marre pergjigje per shkresen e kerkuar. Edmond Duricip yet per rrugen Durice.Z. Albin thote qe punimet do te fillojne se shpejti. Verpa Halili thote per kerkesen ne lidhje me ngritjen e nje komisioni per ndjekjen dhe hetimin e procedurave. Thekson se mbledhja e komisioneve per arsye te ndryshme nuk eshte mbledhur. Z.Arben Cupi thote qe do te mblidhemi dhe do te diskutojme per komisionet. Veap Halili pyet per nenstacionin e Lagjes Gjeologu, nje problem qe vazhdon prej kohesh.Sygjeron qe te futet ne projekt buxhetin e vitit te ardhshem. Ka kerkuar gjithashtu qe te behet pjese per konsultimin me zyrat perkatese ne lidhje me buxhetin.

Projekt Vendim per 6 % e ndihmes ekonomike , prezanton Klajdjola Hoxha.Hidhet ne votim dhe miratohet me 14 vota pro.

Projekt Vendim per miratimin e Programit Buxhetor Afatmesem 2026-2028 . Prezanton Matilda Isaku.Arjan Hoxha pyet nese ka ndonje ndryshim. Hidhe t ne votim me 12 vota pro , 2 kunder.

Per miratimin e Raportit te Monitorimit te Bashkise Bulqize 2025 Janar Gusht.Prezanton Matilda Isaku. Pas mbledhjes se komisionit te Ekonomise vazhdojme me diskutimet e rradhes. Hidhet ne votim pika 6 dhe miratohet me 12 pro, 1 kunder. 2 abstenim..

Projekt vendim pika 7 per nje shtese dhe nje ndryshim ne VKB nr.89 date 26.12.2024. Prezanton Matilda Isaku. Zjarrefikesit marrin 3 paga. Hidhet ne votim me 16 vota pro.

Projekt vendim nr 8 per Transferimin e kapitalit te vleres s e aktiveve te qendrushme te trupezuara, rrjeti Ujesjelles ne Shoqerine Rajonale Ujesjlle sha Diber me vlere 1 591 645 840 leke nga Bashkia Bulqize. Prezanton Shkendije Osmani. Veap Halili pyet a ekzistojne keto ujesjellesa pasi ka ujesjellesa qe kane realisht probleme. A ka mundesi qe te kete nje raport perfundimtar? Z.Albin thote qe kalimi I aseteve behet qe ato te kene te drejte te veprojne ne keto asete, pasi ato nuk jane te Bashkise. Z.Vilson Sula thote qe ne si Bashki na I kane hequr te drejtat per te vepruar dhe as ato nuk mund te veprojne po nuk u kaluan keto asete. Gerta Jella thote qe me rekomandim te KLSH-se duhet te kalojne tek Drejtoria e Ujesjellesit .

Z.Arjan Hoxha pyet a do te kete komision nga Bashkia? Ku mund te ankojemi kur keto asete te kalojne te ujesjellesi? Shkelqim Begu thote qe gjysma e qytetit te Ri eshte pa sahare. Keshilltaret thote qe pas kalimit te kapitalit ato mund te rrisin dhe cmimin e ujit. .Haxhi Pulja dhe Z.Vilson Sula thote qe nese nuk vjen ne Keshill per miratim ato nuk mund te rrisin cmimet. Veap Halili thote qe ky eshte nje problem I mbartur. Ne si Bashki a kemi nje informacion te sakte per keto ujesjellesa? Psh ujesjellesi I Gjorices ka probleme dhe eshte jashte funksionit. Ne vlere kapitale figuron, por a ekziston realisht? Z.Albin thote qe praktikisht jane te dorezuara. Duhet te behen procedurat. Z.Vilson Sula thote qe po nuk kaluan mundesite e investimit jane 0. Z.Vilson Sula thote qe ne grupin e komisionit duhet te jete edhe 1 person nga Keshilli Bashkiak.

Z.Arjan Hoxha thote a do te merren parasysh kerkesat dhe ankesat e qytetareve nga Ujesjellesi dhe sa llogari mund tju kerkojme ne atyre? Hidhet ne votim me 11 vota pro, 4 abstenim, 1 kunder.

Projekt vendim per disa ndryshime ne VKB nr.89. Prezanton Haxhi Pulja nga Agjensia e funksioneve te

Tranferueshme. Hidhet ne votim dhe miratohet me 12 pro, 1 kunder, 3 abstenim.

Projekt vendim per nivelin e taksave, administrimin e tyre ne Bashkine Bulqize. Prezanton Rakip Hoxha. Veap Halili pyet nese ka ndryshuar numri I subjekte te regjistruar dhe ato te mbyllur. Rakip Hoxha thote qe ka regjistrime te reja dhe mbyllje. Vepa Halili pyet per renten minerare. Z. Rakip hoxha thote qe nuk ka parashikim te sakte, Viti 2024 ka pasur vlere me te larte. Veap Halili pyet per kundravajtjet administrative pasi ne projekt e kane vleren 0. Pse nuk ka funksionuar? As policia as zjarrefikesja , duket qe ato nuk kane funksionuar ne detyrat e tyre. Edmond Durici pyet a jane paguar taksat ng ate gjitha subjektet? Kryetarja pyet si jemi me te ardhurat nga viti 2024 deri me tani. Z. Rakip Hoxha thote qe kete vit te ardhurat jane me te larta . Shkelqim Begu pyet per tarifate e Heceve. Si maten, si kontrollohen? Z. Rakip Hoxha thote se vijne regjistrat nga Ministria dhe ne baze te vleresimit te tyre merren taksat. Veap Halili thote qe per biznesin e vogel, familjar te jete 30% me e ulet. Biznesi te nzitet te paguaje ne 6 mujorin e pare. Shkelqim Begu thote qe subjektit ti thuhet qe nese paguan Brenda 6 mujorit te pare, do te kete 30% ulje. Veap Halili kerkon qe te hidhet ne votim propozimi per uljen e taksave. Shkelqim Begu thote qe kush te hape biznes te ri, te perjashtohet nga taksat per nje vit. Hidhet ne votim propozimi I Veap Halilitne lidhje me ndryshimetne taksat. Votohet dhe miratohet me 14 vota pro. 1 kunder. Projekt vendimi I taksave miratohet me 16 vota pro.

Projekt vendim “ mbi dhenien ne perdorim te siperfaqes pyjore kullosore sipas lejes minerare 476/3 date 19.04.2017. Prezanton Shaqir Izvira. Hidhet ne votim me 13 vota pro., 1 kunder, 1 abstenim.

Projekt vendim mbi dhenien ne perdorim te siperfaqes pyjore kullosore per shesh depozitimi dhe sherbime te tjera sipas lejes minerare 1214/3 date 21.07.2008. Prezanton Shaqir Izvira. Hidhet ne votim dhe miratohet me 13 vota pro., 1 kunder,

Projekt vendim mbi dhenien ne perdorim te siperfaqes pyjore kullosore per shesh depozitimi dhe sherbime te tjera sipas lejes minerare 787/2 date 05.12.2023. Hidhet ne votim dhe miratohet me 14 vota pro, asnje kunder dhe 2 abstenim.

Projekt vendim per miratimin ne parim te dhenies ne perdorim per ndertim aerogenerator , fotovoltai (stacione bazamente dhe objekte perkatese ne pasurine me siperfaqe totale 21 ha. Prezanton Shaqir Izvira. Hidhet ne votim dhe miratohet me 15 vota pro, asnje kunder dhe 1 abstenim.

Projekt vendim per miratimin ne parim te dhenies ne perdorim per ndertim aerogenerator , fotovoltai (stacione bazamente dhe objekte perkatese ne pasurine me siperfaqe totale 85.9 ha. Prezanton Shaqir Izvira. Hidhet ne votim dhe miratohet me 15 vota pro, asnje kunder dhe 1 abstenim.

Shenim: Projekt vendimi nr 33 date 29.10.2025 eshte per: heqjen nga fondi pyjor kullosor sipas shkreses se Ministrise se Turizmit dhe Mjedisit me leje minerare 878/2 date 05.12.2023. Vota: 14 vota pro, asnje kunder , 2 abstenim.

Vepa Halili kerkon qe per piken 8 te rendit te dites te shkruhet kush votoi pro, kunder dhe abstenim.

Vota Pro: Silva Duka, Behar Cani, Arjan hoxha, Edmond Duriçi, Mariglen Dani, Ravjola Kaja, Brulind Sinani, Valbona Jani, Arben Çupi, Munir Sinani. Vota kunder: Ernold Cupi. Vota abstenim: Vepa Halili, Elkie Duriçi,

Shkelqim Begu, Endrit Meta.

Ravjola Kaja Silva Duka Arjan Pasha Munir Sinani Valbona Jani
Arjan Hoxha Behar Cani Shkelqim Begu Edmond Duriçi Ernold Çupi
Endrit Meta

Mbajtes i
Proceverbalit
Klodian Reçi

PROCESVERBAL

Procesverbal i mbajtur sot me datë 10.12.2025, mbledhje e shtyre e datës 04.12.2025, në sallën e Këshillit Bashkiak Bulqizë. Hap mbledhjen zoti Arben Çupi. Marrin pjesë këshilltarët: Munir Sinani, Arben Çupi, Valbona Jani, Endrit Meta, Gëzim Xhafa, Visjana Limani, Ravjola Kaja, Edmond Durici, Maringlen Dani, Arjan Pasha, Veap Halili, Shkelqim Begu, Behar Cani, Arjan Hoxha. Zoti Arben Çupi lexon rendin e ditës. Hiqet pika 2 dhe pika 9 nga rendi i ditës. Pika 2 do të diskutohet në mbledhjen tjetër. Hidhet në votim rendi i ditës me ndryshimet e rendit të ditës. Miratohet me 14 vota pro. Diskutohet për pikën 2 të njoftimit të rendit të ditës. Zoti Mufid Duriçi thotë që është një interes biznesi për të gjithë. Ne kërkojmë vetëm stacion ndarimi për qytetarët, jo të hiqet terminali. Vetëm të hipin dhe zbresin njerëzit. Kjo kërkesë është bërë prej kohësh, pasi janë punë publike që duhen bërë.

Zoti Lulëzim Kurti thotë që kërkesa është për vendqëndrim. Zoti Shkelqim Begu thotë që interesi është i banorëve. Nuk duan të heqin terminalin, thjesht të ndalojnë furgonët për të marrë njerëzit. Veap Halili thotë që unë kam bërë kërkesë për këtë pikë edhe nuk kam asnjë interes. Tagrin për lëvizjen e automjeteve në qytet e ka kryetari i bashkisë dhe Këshilli Bashkiak. Interesi i qytetarëve dhe bizneseve është të ketë stacione madje në pika të ndryshme. Veap Halili thotë që për linjat rrethqytetëse, lidhin njësitë administrative me qytetin e Bulqizës. Këshilli Bashkiak duhet të miratojë çdo tre vjet pika ndalimi stacione dhe . automjetet duhet të ndalojnë në pikën e stacionit. Zoti Munir Sinani thotë që ti Mufit duhet ta kishe zgjidhur sa ishte ne detyre.

Vazhdohet me pikën tre, miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 6.11.2025. Dhe miratohet. Shkelqim Begu pyet për zgjedhjen e kryepleqve të fshatrave të ndryshme. Zoti Arjan Hoxha thotë që kush ka dhene dorheqje të sjellë vulët para mbledhjes së ardhshme. Shkelqim Begu thotë që tre anëtarë kryesie kanë të drejtë të votojnë. Tek të ndryshmet, Veap Halili thotë për komisionin që ka bërë kërkesë në lidhje me disa procedura që duhen. Hidhet në votim propozimi dhe pesë anëtarë të Këshillit dhanë pëlqimin për të bërë pjesë. Vap Halili, Shkelqim Begu, Arian Hoxha, Endrit Meta, Maringlen Dani. Zoti Fatri Puca jep informacion në lidhje me klubin e futbollit. Arian Hoxha thotë se sa përqind ka bashkia. Zoti Fatri Puca thotë 100% e ka bashkia. Kemi bërë kërkesa, por për arsye të ndryshme nuk kemi arritur ndonjë kontratë. Veap Halili thotë që bashkia duhet të nxjerrë në ankand ekipin e futbollit pasi nuk e ka tagrin ta investosh. Këtë e thotë ligji.

Nga një status të kalojë në status tjetër. Veap Halili pyet për ekipin e moshave që ta shikohen më shumë pasi interesi tek këto mosha është edhe më i madh. Investimi të jetë për këto grupmosha. Zoti Endrit Meta ngre shqetësimin për ujin e pijshëm, për orarin, të paktën të shtyhet me një orë më shumë. Kush është nga bashkia në bordin e ujësjellësit që ne mund të marrim informacion. Zoti Shkëlqim Begu për kërkesën e fshatit Vajkal. Sa për shtyrjen e orarit të ujit, kryetarja thotë që nuk mund të shtyhet pasi nuk ka ujë depozita, pas komunikimit me drejtorin e ujësjellësit.

Sa për kërkesën e fshatit Vajkal, zoti Albin Bodini thotë që nuk mund të futet direkt pa u parë buxheti. Do të merren parasysh ato më emergjentet.

Projektvendim për 6%shin e muajit tetor. Veap Halili dhe Endrit Meta propozojnë që nëse ka buxhet të ndihmohet familja e të ndjerit, Erion Boba. Nëse ka buxhet këshilli të merret nga aty. Hidhet në votim 6% dhe miratohet me 14 vota pro. Projektvendim për numrin e punonjësve dhe nivelin e pagave të bashkisë Bulqizë, prezanton Shkëlqim Dema. Veap Halili thotë që në mbledhjen e komisionit është diskutuar për nivelin e performancës së punonjësve të bashkisë. Thotë që mundësia për rishikim të pagave në bazë të performancës është për t'u marrë parasysh, pasi jo çdo drejtori ka të njëjtën performancë. Te ardhurat që ngelen të shkojnë për investime. Zoti Arjan Hoxha thotë që në mbledhje të diskutohet dhe lexohet procesverbali i komisioneve. Hidhet në votim dhe miratohet me 11 vota pro. Dy abstenim, Veap Halili dhe Shkëlqim Begu. Projektvendim për punonjësit dhe nivelin e pagave të agjencisë së funksioneve të transferueshme. Prezanton Haxhi Pulja. Shkëlqim Begu dhe Edmond Duriçi propozojnë rritje page për punonjësit me paga të ulëta. Veap Halili thotë që si ndërmarrje ka shumë probleme dhe ne duhet të kete shtim organike ose ndryshim strukture. Hidhet në votim dhe miratohet me 12 vota pro, një abstenim dhe Veap Halili.

Projekti vendim ndërtim muri mbajtës rruga Zall Sopot , Zerqan. Arjan Hoxha thotë që duhet foto nga grupi i punës gjatë inspektimit. Prezanton Selim Alliu, hidhet në votim me 13 vota pro. Projekt vendim për miratim fondi për ndihmë shteterore financiare për zotën Skënder Tasha. Hidhet në votim dhe miratohet me 13 vota pro. Projekt vendim për përdorim të fondit të emergjencës për ndërhyrje emergjente ndërtim muri mbajtës të rrugës, lagjja Xhete, fshati Boçeve, njësia administrative Shupenze. Hidhet në votim dhe miratohet me 13 vota pro. Projekt vendim për përdorim fondit të emergjencës për ndërhyrje emergjente, ndërtim muri me gabion për mbrojtjen e tokave bujqësore, fshati Peladhi. Hidhet në votim dhe miratohet me 13 vota pro. Projekt vendim, miratim fondi për ndihmë shteterore financiare për zotën Ali Çishkeku. Hidhet në votim dhe miratohet me 13 vota pro .

Z. Arben Çupi deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Edmond Duriçi, Munir Sinani, Behar Cani, Gëzim Xhafa, Valbona Jani, Arjan Hoxha, Arjan Pasha, Visiana Limani, Ravjola Kaja, Meringlen Dani, Arben Çupi, Shkëlqim Begu.

Mbajtësi i procesverbalit Klodian Reçi.

PROCESVERBAL

Procesverbal i mbajtur sot me datë 24.12.2025 në sallën e Këshillit Bashkiak Bulqizë. Hap mbledhjen zoti Arben Çupi. Marrin pjesë këshilltarët: Arben Çupi, Munir Sinani, Valbona Jani, Greta Tançi, Gëzim Xhafa, Raviola Kaja, Brulind Sinani, Visjana Limani, Maringlen Dani, Edmond Durici, Arjan Hoxha, Behar Çani, Shaqir Manjani, Veap Halili, Elkier Durici, Arjan Pasha.

Zoti Arben Çupi lexon rendin e ditës. Listen e projektvendimeve. Hidhet në votim rendi i ditës me 14 vota pro, një kundër dhe një abstenim. Hidhet në miratim pika dy e rendit të ditës mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së muajit nëntor 2025 me vota pro 16 dhe kundër zero. Tek të ndryshme hidhet në diskutim kërkesa për komision të përkohshëm ku lidh mundësia e vetëpropozimeve për ngritjen e komisionit të përkohshëm. Miratohet me 16 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim. Tek të ndryshme hidhet në votim për miratim kërkesa për dorheqje nga Silva Duka, me 13 vota pro, tre abstenim.

6% Korab Kika prezanton projektvendimin për fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike 6% për muajin nëntor 2025. Relatoj të gjitha pikat sipas projektvendimit si dhe nevojën e banorëve për këtë fond. Hidhet në votim me 16 vota pro dhe asnjë kundër. Veap Halili thotë: Pse ka vonesa për shpërndarjen e ndihmës ekonomike? Korab Kika thotë se të gjitha janë paguar në kohë. Veap Halili pyet sërish ndihmën financiare që u ka kërkuar mbledhjen e kaluar. Vilson Sula, vlera e mbetur do të shpërndahen tek dy familje në nevojë me 16 vota pro.

Hidhet në votim ndihma financiare për dy familje në nevojë dhe një fëmijë e të ndjerit nga fushë Bulqiza, ku 100.000 për familje dhe në të tjerët dhe 50.000 për dy familje të tjera. Projekt vendim për dhënien e bursave të shtetit për nxënësit e arsimit profesional në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2025-2026. Marsida Murja paraqet numrin e kuotave sipas kriterëve dhe jep relacion për të gjithë projektvendimin. Veap Halili, çdo kërkesë është miratuar: Marsida Murja thotë që çdo kërkesë është miratuar sipas kushteve të vendosura në skemën përfituese. Veap Halili pyet nëse janë bërë kurse për zhvillim shtesë pas orarit mësimor dhe është diskutuar pjesa e ushqimeve. Marsida Murja, po janë të hapura, ndërsa për ushqimin nuk kemi konfirmim nga ministria. Miratohet me shumicë votash 16 pro, kundër, abstenim s'ka. Prezantohet projektvendimi për dhënien e bursave të shtetit për nxënësit e arsimit profesional në institucionet arsimore publike, banorë të bashkisë Bulqizë për vitin 2025. Miratohet me shumicë votash 16. Projektvendim për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2026, prezanton Rustem Bici. Si është ndarë projektbuxheti, pyet Munir Ainani. si njësi administrative, sipas njërive administrative nga 17 programe, Matilda Isaku përgjigjet. Veap Halili paraqet një amendament që ka lënë për të shqyrtuar, për diskutim duke prekur anën sociale të qytetarëve dhe kërkon të votohet në këshill, jo komision. Dhe lexon të gjithë pikat e paraqitura në amendament. Shaqir Manjani lidhur me alokimin e fondit në fushë Bulqizë, pse është vendosur ajo shumë e vogël. Kryetari i Këshillit përgjigjet që kjo është në diskutim tek investime. Hidhet në miratim pika 7 e projektvendimit, për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2026 me 13 vota pro. Matilda Isaku prezanton projektvendimin për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028. Hidhet në votim me 13 vota pro dhe një kundër. Matilda Isaku prezanton projektvendimin për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe buxhetit vjetor 2026, ku relaton të gjitha procedurat dhe afatet kohore të buxhetit. Hidhet në votim me 13 vota pro, ku miratohet. Albin Bodini prezanton projektvendimin lidhur me investimet për vitin 2026. Shaqir Manjani pyet, lista duhet të relatohet para e buxhetit, pse e sjell pasi është paraqitur buxheti. Albin Bodini përgjigjet se amendamenti ka pika që janë kaluar në buxhet. hidhet në votim me 12 vota pro dhe dy kundër. Klodian Reçi

prezanton projektvendimin, buxheti i Këshillit Bashkiak Bulqizë, plani i aktiviteteve dhe plani i konsultimeve për vitin 2026. Relaton të gjitha zërat e vendosura. Hidhet në votim me shtesë 50% të buxhetit dhe miratohet me 13 vota pro dhe tre abstenim. Eva Koltraka, informacion mbi raportin e performancës së Bashkisë Bulqizë për vitin 2024. Arben Çupi deklaron mbledhjen të mbyllur.

Munir Sinani, Behar Cani, Visjana Limani, Valbona Jani, Arben Çupi, Ravjola Kaja, Edmond Duriçi, Maringlen Dani, Greta Tanci, Arjan Hoxha, Gëzim Xhafa, Arjan Pasha.